

Politika e Privatësisë

DelCo doel respekton privatësinë e vizitorëve dhe angazhohet për sigurinë tuaj në rrjet duke e ruajtur privatësinë tuaj në çdo kohë që vizitoni ose komunikoni me faqen tonë të internetit.

Politika jonë e Privatësisë dhe Kushtet e Përdorimit ju japin mëposhtë një shpjegim të detajuar lidhur me të dhënat personale të dhëna nga ju dhe çdo të dhëne tjetër që ne mund të mbledhim nga ju.

Politika e Privatësisë përditësohet kohë pas kohe, prandaj duhet që herë pas here të rishikohet.

1. Informacioni i mbledhur

1.1 Përgjatë funksionimit të faqes sonë të internetit mund të grumbullohen dhe përpunohen të dhëna. Mënyrat se si mund t'i kryejmë këto operacione janë si më poshtë:

- Mblidhen të dhëna mbi vizitën tuaj (vizitat e juaja) në faqen tonë të internetit dhe burimet e përdorura. Kjo përfshin, por nuk kufizohet vetëm në: informacion rreth kompjuterit tuaj dhe në lidhje me vizitat dhe përdorimin e kësaj faqeje interneti (duke përfshirë IP adresën tuaj, vendndodhjen gjeografike, llojin dhe versionin e shfletuesit, sistemin operativ, burimin e referimit, kohëzgjatjen e vizitës, shikimet e faqes dhe navigimin në faqen e internetit).
- Çdo formë që e keni plotësuar në faqen tonë na mundëson të mbledhim të dhëna, p.sh. kur regjistroheni për informacion ose kur abonoheni në shërbimet e faqes sonë të internetit, njoftimet me email dhe/ose buletinet, kur plotësoni një pyetësor, aplikim për rekrutim etj. Ne grumbullojmë informacionin me të cilin na pajisni ju gjatë regjistrimit në sistemin tonë, duke përfshirë emrin, mbiemrin, adresën, numrat e telefonit, adresat e emailit, numrin e regjistrimit, fotografinë, CV-të etj.
- Nëse për çfarëdo arsye ju komunikoni me stafin ose faqen tonë të internetit, ne mund të bëjmë mbledhjen e informacionit.

2. Përdorimi i informacionit tuaj

2.1 Informacioni i ruajtur ose i mbledhur në lidhje me ju, na ndihmon të përmirësojmë dhe t'ju ofrojmë shërbimet që ju nevojiten. Të dhënat personale të transmetuara nëpërmjet kësaj faqe interneti do të përdoren për qëllimet e deklaruara në këtë politikë të privatësisë ose në pjesët relevante të faqes së internetit.

2.2 Lista e mëposhtme mënyrën se si ne mund t'i përdorim të dhënat e juaja:

- Çdo kërkesë që bëni në faqen tonë të internetit ose stafit tonë, na lejon që të përdorim informacionin të cilin ju na transmetoni, në lidhje me produktet ose shërbimet të cilat ne i ofrojmë. Ne gjithashtu mund t'ju dërgojmë informacione për produktet ose shërbimet të cilat mund t'ju interesojnë, për sa kohë që ju keni dhënë pëlqimin tuaj.
- Angazhimi për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale: përmbushja e çdo detyrimi kontraktual që kemi ndaj jush.
- Ndryshimet ose përmirësimet e bëra në faqen e internetit mund të kërkojnë përdorimin e të dhënave tuaja me qëllim të njoftimit për ndryshimet e reja.
- Një klient ekzistues mund të kontaktohet për produktet dhe shërbimet që lidhen me ndonjë veprimtari të mëparshme që keni bërë në faqen tonë të internetit.
- Çdo klient i ri mund të kontaktohet nga ne ose nga palët e treta nëse ai ka rënë dakord përmes faqes sonë të internetit. Ne dërgojmë korrespondencë vetëm nëse paraprakisht kemi siguruar pëlqimin tuaj për një gjë të tillë.
- Kushdo i cili nuk dëshiron të japë pëlqimin për përdorim nga faqja jonë ose nga ndonjë palë e tretë, ka mundësinë ta refuzojë atë. Sapo të marrim informacionin rreth refuzimit të pëlqimit, tërheqim detajet e kontaktit tuaj nga të gjitha listat e korrespondencës ose komunikimet me palët e treta.
- Asnjë nga të dhënat e mbledhura për ju nuk do të përmbajë veçori të identifikueshme. Informacioni i ndarë me palët e treta është vetëm statistikor. Ne nuk zbulojmë identitetin tuaj, por ne vetëm do të ndajmë informata matematikore për vizitorët tanë.

3. Ruajtja e të dhënave personale

3.1 Të dhënat e grumbulluara rreth jush mund të transferohen edhe në vende të caktuara jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë. Këto vende të të dhënave janë për

ruajtjen ose përpunimin e informacionit tuaj. Të dhënat e dërguara jashtë Republikës së Maqedonisë mund të ndahen me personelin që punon në përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave të lartpërmendura. Kjo mund të përfshijë procese të tilla si përpunimi i pagesës ose asistimi në përmbushjen e kërkesave të shërbimit ose të produktit. Stafii i cili përpunon ose ruan të dhënat mund të punojë për furnizuesit tanë jashtë Republikës së Maqedonisë. Duke dorëzuar të dhënat e juaja për shfrytëzim, ju bini dakord gjithashtu edhe për transferimin dhe ruajtjen e të dhënave. Ne nga ana tjetër ndërmarrim të gjitha masat e duhura për të garantuar sigurinë e të dhënave tuaja personale në përputhje me këtë Politikë të Privatësisë.

- 3.2 Të dhënat që mbledhim do të ruhen në servera të sigurtë dhe për sigurinë tuaj, të dhënat e transaksioneve janë të koduara.
- 3.3 Nënkuptohe se transferimi i të dhënave në rrjet nuk është plotësisht i sigurt. Ne nuk mund të garantojmë mbrojtje dhe siguri të plotë të të dhënave, por ne garantojmë se i ndërmarrim të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur të dhënat që ne marrim në mënyrë elektronike. Transferimi i të dhënave nga ju është në rrezikun tuaj. Qasja në një pjesë të faqes sonë kërkon plotësimin e fjalëkalimit. Ju jeni përgjegjës për sigurinë e fjalëkalimeve dhe për konfidencialitetin e tyre.

4. Zbulimi i të dhënave

- 4.1 Herë pas here, në rast se është e nevojshme ne mund të ndajmë informacion personalisht të identifikueshëm me personat që janë pjesë e grupit tonë. Këtu përfshihen filialet në grupin tonë, holding kompanitë dhe çdo degë tjetër që është pjesë e biznesit tonë.
- 4.2 Dhënia e informacionit palëve të tretë mund të ndodh për shkak të arsyeve të mëposhtme:
 - Shitja e një pjese ose shitja e gjithë biznesit tonë tek një palë e tretë mund të rezultojë në zbulimin e të dhënave tuaja.
 - Në rast se kërkohet me ligj, në çdo kohë mund të zbulojmë të dhëna për ju dhe vizitat e juaja në faqet tona të internetit.

- Mëtutje, ne mund të zbulojmë të dhëna të caktuara për të parandaluar mashtrimet dhe për të ndihmuar në mbrojtjen kundër mashtrimeve me qëllim që të zvogëlohet rreziku i kredisë.

5. Lidhjet e palëve të treta

- 5.1 Në faqen tonë të internetit mund të gjenden lidhje nga palët e treta. Këto lidhje kanë politikat e tyre të privatësisë të cilat ju i pranoni kur klikoni në linkun përkatës. Ne nuk jemi përgjegjës dhe nuk marrim përgjegjësi për lidhjet e palëve të treta. Përgjegjësia jonë kufizohet vetëm me faqen tonë, përgjegjësia për lidhjet e palëve të treta përjashtohet për shkak se nuk kemi kontroll mbi to.

6. Aksesueshmëria e informacionit

- 6.1 Sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 07/05, 103/08, 124/10 dhe 135/11), nuk mund të refuzohet qasja e juaj në informacionin e grumbulluar rreth jush. Ligji i sipërpërmendur ju siguron qasje në çdo informacion të ruajtur rreth jush.

7. Kontakti

- 7.1 Ju lutemi mos hezitoni të na kontaktoni në rast se keni ndonjë pyetje, kërkesë ose koment lidhur në lidhje me politikën tonë të privatësisë. Emaili juaj gjithmonë është i mirëseardhur në: office@delco.com.mk.